



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.601-2/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Violeta Husaj Rugova, dhe Hajriz Hoti, anëtarë, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim Anr.601-8/2025, të parashtruar nga subjekti politik Koalicioni PDAK-LPB, me seli në Komuna Ferizaj, të parashtruar kundër vendimit të PZAP-it Anr.601/2025 datë 21.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.03.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR, kërkesa A.nr.601-8/2025 datë 26.02.2025, e Koalicionit PDAK-LPB, me seli në Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar rishqyrtimin dhe anulimin e vendimit të PZAP-it, Anr.601/2025 datë 21.02.2025, kundër subjektit politik Partia Ashkalinjëve për Integrim (PAI), me seli në Komuna Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09.02.2025.

A r s y e t i m

Paneli me Vendimin Anr.601/2025 datë 21.02.2025, ka vendos të hedhë të pasafatshme ankesën e parashtruar nga Koalicioni PDAK-LPB, me seli në Komuna Ferizaj, për shkak të ndikimit të votuesve jashtë Kosove.

Në PZAP-ë, me datë 26.02.2025, është parashtruar kërkesa për rishqyrtimin e vendimit Anr.601/2025 datë 21.02.2025, nga ana e Koalicionit PDAK-LPB, me seli në Komuna Ferizaj, lidhur me pretendimet se ekziston dyshimi i arsyeshëm i përfshirjes së subjektit politik PAI dhe anëtarëve të saj ku në mënyrë sistematike prej muajit Shtatorit 2024 deri me datë 9 Shkurt 2025, kanë ndikuar në përcaktimin e lirë të votuesve, duke keqpërdorur të dhënat e tyre dhe duke shfrytëzuar mos dijeninë e tyre duke votuar për ta në votat e diasporës. Në kërkesën për rishqyrtim nga Koalicioni PDAK-LPB, pretendojnë se bazuar në përgjigjen e PZAP-së, duke e cilësuar ankesën si të paafatshme, mendojnë që i'u është bërë e padrejtë pasi që numërimi i votave të diasporës ende nuk ka nisur dhe se ata po kërkojnë verifikim dhe hetim mbi rastin e mënyrës së organizimit të votuesve të diasporës, pasi që mendojnë që kanë të bëjnë me orkestrim të votave për faktin që pjesa e dëshmimeve të provave dhe informacioneve lidhur me procesin zgjedhor, si orkestrimi, votimi, apo edhe pjesa e shantazhit dhe joshjes kanë ardhur këto ditë dhe në momentin që kanë marrë njohuri ju kanë drejtuar PZAP-it, dhe organeve të prokurorisë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se : - **kërkesa për rishqyrtim dhe anulimin e vendimit A.nr.601/2025 datë 21.02.2025, është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, dhe duke u bazuar në kërkesën A.nr.601-8/2025 datë 26.02.2025, për rishqyrtimin e vendimit A.nr.601/2025 të datës 21.02.2025 konstatohet se Koalicioni PDAK-LPB, me seli në Komuna Ferizaj konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesë në PZAP me datë 20.02.2025, ku ka pretenduar se ka pasur parregullësi në mënyrë sistematike te votuesit nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve datë 09.02.2025. Megjithatë, PZAP me vendimin A.nr.601/2025 datë 21.02.2025 ka konstatuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, bazuar në nenin 39 paragrafi 3 dhe 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 20.02.2025, në ora 16:00, ndërsa parregullsitë me të cilin pretendon pala ankuese është nga muaji shtator 2024 deri në ditën e zgjedhjeve më datë 09.02.2025 lidhur me shkeljet e pretenduara, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Në nenin 118 paragrafi 4 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se : *“Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.*

Në rastin konkret Koalicioni PDAK-LPB, kërkesën për rishikim të vendimit A.nr.601/2025 datë 21.02.2025 nuk e ka mbështetur në asnjë provë apo fakt të ri, që do ta bind panelin në PZAP që të njëjtën kërkesë ta aprovojë si të bazuar.

PZAP-i, më datë 28.02.2025 ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A.A.nr.52/2025 me të cilën është vërtetuar Vendimi i PZAP-it Anr.601-2025 datë 21.02.2025.

Prandaj PZAP-i, duke u bazuar në arsyet e lartcekura vendosi që kërkesën për rishqyrtim të refuzojë si të pabazuar në kuptim të nenit 118 paragrafin 4 e lidhur me nenin 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
Anr.601-2/2025 datë 07.03.2025



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të Ligji Nr.08/L-228, për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës.